


United Nations
Nations UniesInternational Criminal Tribunal
for the former Yugoslavia
Tribunal Pénal International
pour l'ex-Yougoslavie

(IT-05-87) SHAINOVIQI dhe të tjerë *

Prokurori kundër Nikolla Shainoviqit, Dragolub Ojdaniqit, Nebojsa Pavkoviqit, Vladimir Lazareviciq, Sreten Llukiqit dhe Millan Millutinoviqit



NIKOLLA SHAINOVIQ	<i>I shpallur fajtor për dëbime; veprime të tjera çnjerëzore (transferim i dhunshëm); vrasje dhe përndjekje mbi baza politike, racore ose fetare</i>
	<p>Prej shkurtit 1994 deri në nëntor 2000 Zëvendëskryeministër i Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbi dhe Mal i Zi).</p> <ul style="list-style-type: none"> - U dënua me 22 vjet burg


Krimet për të cilat u shpall fajtor (shembuj):

Dëbim, veprime të tjera çnjerëzore (transferim i dhunshëm), vrasje, përndjekje mbi baza politike, racore ose fetare (krime kundër njerëzimit) dhe

Vrasje (shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës)

- Nikolla Shainoviq kishte synimin e shpërnguljes me dhunë të një pjese të popullatës shqiptare si brenda po ashtu edhe jashtë Kosovës dhe në këtë mënyrë ndryshimin e përbërjes etnike në krahinë për të mundësuar vazhdimësinë e kontrollit të krahinës prej RFJ-së dhe Serbisë.
- Ai ishte përgjegjës për kryerjen (nëpërmjet pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale) e një sërë krimesh të specifikuar në aktgjykim në vendet e mëposhtme në Kosovë: Pejë, Deçan, Gjakovë, Prizren, Rahovec, Suharekë, Skënderaj, Mitrovicë, Vushtrri, Prishtinë, Gjilan, Ferizaj dhe Kaçanik.

NIKOLLA SHAINOVIQ	
Lindur	7 dhjetor 1948 në Bor, Serbi
Aktakuza	Aktakuza fillestare: 24 maj 1999, u bë publike më 27 maj 1999; aktakuza e ndryshuar: 29 qershor 2001; aktakuza e ndryshuar për herë të dytë: 29 tetor 2001; aktakuza e ndryshuar për herë të tretë: 5 shtator 2002; aktakuza e ndryshuar për herë të tretë e përbashkët e redaktuar: 26 qershor 2006
Dorëzuar	2 maj 2002
Transferuar në TPNJ	2 maj 2002
Paraqitja e parë	3 maj 2002, u vetëdeklarua i pafajshëm për të tëra akuzat
Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore	26 shkurt 2009, u dënua me 22 vjet burg


DRAGOLUB OJDANIQ <i>I shpallur fajtor për dëbim dhe veprime të tjera çnjerëzore (transferim i dhunshëm)</i>	
	<p>Prej 24 nëntorit 1998, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave (UJ); prej 15 shkurtit 2000 deri më 3 nëntor 2000, Ministër i Mbrojtjes i Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbi dhe Mal i Zi)</p> <ul style="list-style-type: none"> - U dënua me 15 vjet burg

Krimet për të cilat u shpall fajtor (shembuj):

Dëbim, veprime të tjera çnjerëzore (transferim i dhunshëm) (krime kundër njerëzimit)

- Dragolub Ojdaniqi ishte në dijeni të fushatës së terrorit, dhunës dhe kryerjes së shpërnguljes me dhunë prej forcave të UJ-së dhe Ministrisë të Punëve të Brendshme Serbe (MPB-së) kundër popullatës shqiptare kosovare e megjithatë iu shmang marrjes së masave efektive që i takonin, si hetimi konkret i shpërnguljeve me dhunë megjithëse kishte dijeni për incidentet.
- Ai ishte përgjegjës për ndihmesë dhe inkurajim të krimeve në këto vende: Pejë, Gjakovë, Prizren, Rahovec, Skënderaj, Prishtinë, Gjilan, Ferizaj dhe Kaçanik.

DRAGOLUB OJDANIQ	
Lindur	1 qershor 1941 në fshatin Ravni, komuna e Uzhicës, Serbi
Aktakuza	Aktakuza fillestare: 24 maj 1999, u bë publike më 27 maj 1999; aktakuza e ndryshuar: 29 qershor 2001; aktakuza e ndryshuar për herë të dytë: 29 tetor 2001; aktakuza e ndryshuar për herë të tretë: 5 shtator 2002; aktakuza e ndryshuar për herë të tretë e përbashkët e redaktuar: 26 qershor 2006
Dorëzuar	25 prill 2002
Transferuar në TPNJ	25 prill 2002
Paraqitja e parë	26 prill 2002, u vetëdeklarua i pafajshëm për të tëra akuzat
Aktgjykimi i Dhomës Gjqësore	26 shkurt 2009, u dënua me 15 vjet burg

NEBOJSHA PAVKOVIQ <i>I shpallur fajtor për dëbime; veprime të tjera çnjerëzore (transferim i dhunshëm); vrasje dhe përndjekje mbi baza politike, racore ose fetare</i>	
	<p>Prej 25 dhjetorit 1998 deri në fillim të vitit 2000, Komandant i Armatës së Tretë të UJ-së; prej shkurtit 2000 deri më 24 qershor 2002, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së.</p> <ul style="list-style-type: none"> - U dënua me 22 vjet burg

Krimet për të cilat u shpall fajtor (shembuj):


Dëbim, veprime të tjera çnjerëzore (transferim i dhunshëm), vrasje, përndjekje mbi baza politike, racore ose fetare (krime kundër njerëzimit) dhe

Vrasje (shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës)

- Nebojsa Pavkoviq synonte të shpërngulte me dhunë një pjesë të popullatës shqiptare kosovare, së bashku me anëtarë të tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, objektivi i së cilës ishte shpërngulja me dhunë e shqiptarëve kosovarë brenda Kosovës dhe dëbimi i tyre nga Kosova për ruajtjen e kontrollit mbi krahinën.

- Ai ishte përgjegjës për kryerjen (nëpërmjet pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale) e një sërë krimesh të specifikuar në aktgjykim në vendet e mëposhtme në Kosovë: Pejë, Deçan, Gjakovë, Prizren, Rahovec, Suharekë, Skënderaj, Mitrovicë, Vushtrri, Prishtinë, Gjilan, Ferizaj dhe Kaçanik.

NEBOJSHA PAVKOVIQ	
Lindur	10 prill 1946 në fshatin Senjski Rudnik, komuna Despotovac, Serbi
Aktakuza	Aktakuza fillestare: 2 tetor 2003, u bë publike më 20 tetor 2003; aktakuza e ndryshuar për herë të tretë e përbashkët e redaktuar: 26 qershor 2006
Dorëzuar	25 prill 2005
Transferuar në TPNJ	25 prill 2005
Paraqitja e parë	28 prill 2005, u vetëdeklarua i pafajshëm për të tëra akuzat
Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore	26 shkurt 2009, u dënua me 22 vjet burg


VLLADIMIR LLAZAREVIQ <i>I shpallur fajtor për dëbim dhe veprime të tjera çnjerëzore (transferim i dhunshëm)</i>	
	<p>Prej vitit 1998 Shef i Shtabit të Korpusit të Prishtinës të UJ-së; prej 25 dhjetorit 1998, Komandant i Korpusit të Prishtinës; prej 28 dhjetorit 1999, Shef i Shtabit të Armatës së Tretë të UJ-së; prej 13 marsit 2000, Komandant i Armatës së Tretë të UJ-së.</p> <p>- U dënua me 15 vjet burg</p>

Krimet për të cilat u shpall fajtor (shembuj):

Dëbim, veprime të tjera çnjerëzore (transferim i dhunshëm) (krime kundër njerëzimit)

- Vladimir Lazareviq ishte përgjegjës për ndihmesë dhe inkurajim të krimeve në këto vende: Pejë, Deçan, Gjakovë, Prizren, Rahovec, Skënderaj, Prishtinë, Gjilan dhe Kaçanik.
- Ai u dha ndihmesë praktike, inkurajim dhe përkrahje morale anëtarëve të UJ-së të përfshirë në kryerjen e transferimit të dhunshëm dhe dëbimit në vendet e krimeve të specifikuar, duke ndikuar thelbësisht në kryerjen e këtyre krimeve.

VLLADIMIR LLAZAREVIQ	
Lindur	23 mars 1949 në fshatin Grnçar, komuna e Babushnicës, Serbi
Aktakuza	Aktakuza fillestare: 2 tetor 2003, u bë publike më 20 tetor 2003; aktakuza e përbashkët e ndryshuar, 16 gusht 2005; aktakuza e përbashkët e ndryshuar për herë të dytë, 5 prill 2006; aktakuza e përbashkët e ndryshuar për herë të tretë, 12 maj 2006; aktakuza e ndryshuar për herë të tretë e përbashkët e redaktuar: 26 qershor 2006.
Dorëzuar	3 shkurt 2005
Transferuar në TPNJ	3 shkurt 2005
Paraqitja e parë	7 shkurt 2005, u vetëdeklarua i pafajshëm për të tëra akuzat
Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore	26 shkurt 2009, u dënua me 15 vjet burg

SRETEN LLUKIQ		<i>I shpallur fajtor për dëbime; veprime të tjera çnjerëzore (transferim i dhunshëm); vrasje dhe përndjekje mbi baza politike, racore ose fetare</i>
	<p>Prej majit 1998, Shef i Shtabit të Ministrisë së Brendshme Serbe (MPB) për Kosovën; prej qershorit 1999, Ndihmës shef i Shërbimit të Sigurisë Publike (RJB) dhe Shef i Administratës së Kufirit të Policisë Kufitare në MPB; prej 31 janarit 2001, Ndihmësministër dhe Shef i RJB-së.</p> <p>- U dënua me 22 vjet burg</p>	


Krimet për të cilat u shpall fajtor (shembuj):

Dëbim, veprime të tjera çnjerëzore (transferim i dhunshëm), vrasje, përndjekje mbi baza politike, racore ose fetare (krime kundër njerëzimit) dhe

Vrasje (shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës)

- Sreten Llukiq kishte synimin e shpërnguljes me dhunë të një pjese të popullatës shqiptare si brenda po ashtu edhe jashtë Kosovës për të mundësuar vazhdimësinë e kontrollit të krahinës prej RFJ-së dhe Serbisë.
- Ai ishte përgjegjës për kryerjen (nëpërmjet pjesëmarrjes në një ndërmarrje të përbashkët kriminale) e një sërë krimesh të specifikuar në aktgjykim në vendet e mëposhtme në Kosovë: Pejë, Deçan, Gjakovë, Prizren, Rahovec, Suharekë, Skënderaj, Mitrovicë, Vushtrri, Prishtinë, Gjilan, Ferizaj dhe Kaçanik.

SRETEN LLUKIQ	
Lindur	28 Mars 1955 në Vishegrad, Bosnë dhe Hercegovinë
Aktakuza	Aktakuza e parë: 2 tetor 2003, u bë publike më 20 tetor 2003; aktakuza e ndryshuar për herë të tretë e përbashkët e redaktuar: 26 qershor 2006
Dorëzuar	4 prill 2005
Transferuar në TPNJ	4 prill 2005
Paraqitja e parë dhe të tjera	6 prill 2005, nuk u deklarua; 4 maj 2005, u vetëdeklarua i pafajshëm për të tëra akuzat
Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore	26 shkurt 2009, u dënua me 22 vjet burg

MILLAN MILLUTINOVIQ		<i>U shpall i pafajshëm</i>
	<p>Prej 21 dhjetorit 1997 deri më 29 dhjetor 2002 President i Serbisë dhe anëtar i Këshillit të Lartë të Mbrojtjes të Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbi dhe Mal i Zi).</p> <p>- U lirua nga akuzat</p>	
MILLAN MILLUTINOVIQ		
Lindur	19 dhjetor 1942 në Beograd, Serbi	
Aktakuza	Aktakuza fillestare: 24 maj 1999, u bë publike më 27 maj 1999; aktakuza e ndryshuar: 29 qershor 2001; aktakuza e ndryshuar për herë të dytë: 29 tetor 2001; aktakuza e ndryshuar për herë të tretë: 5 shtator 2002; aktakuza e ndryshuar për herë të tretë e përbashkët e redaktuar: 26 qershor 2006	
Dorëzuar	20 janar 2003	

Transferuar në TPNJ	20 janar 2003
Paraqitja e parë	27 janar 2003, u vetëdeklarua i pafajshëm për të tëra akuzat
Aktgjykimi i Dhomës Gjyqësore	26 shkurt 2009, u shpall i pafajshëm

TË DHËNA

Kohëzgjatja e gjykimit në ditë	285
Dëshmitarë të thirrur prej Prokurorisë	113
Provat materiale të Prokurorisë	1455
Dëshmitarë të thirrur prej Mbrojtjes	118
Provat materiale të Mbrojtjes	2896
Dëshmitarë të thirrur prej Dhomave	2
Provat materiale të Dhomave	18

GJYKIMI	
Filloi	10 korrik 2006
Argumentet përmbyllëse	19 gusht - 27 gusht 2008
Dhoma Gjyqësore III	Kryegjykatës Iain Bonomy, Gjykatës Ali Nawaz Chowhan, Gjykatëse Tsvetana Kamenova, Gjykatëse Janet Nosworthy (Gjykatëse rezervë)
Avokat të Prokurorisë	Thomas Hannis, Chester Stamp, Patricia Neema, Daniela Kravetz
Avokat të Mbrojtjes	Për Millan Millutinoviçin: Eugene O' Sullivan dhe Slobodan Zeçeviç Për Nikolla Shainoviçin: Toma Filla dhe Vlladimir Petroviç Për Dragolub Ojdaniçin: Tomislav Vishnjiç dhe Norman Sepenuk Për Nebojsa Pavkoviçin: John Ackerman dhe Aleksandar Aleksiç Për Vlladimir Llazareviçin: Mihajlo Bakraç and Gjuro Çepiç Për Sreten Llukiqin: Branko Llukiq and Dragan Ivetiç
Aktgjykimi	26 shkurt 2009

APELI	
Dhoma e Apelit	Kryegjykatësi Mehmet Güney, Gjykatësi Fausto Pocar, Gjykatësi Liu Daqun, Gjykatëse Andriësa Vaz dhe Gjykatësi Theodor Meron
Avokat të Prokurorisë	Paul Rogers
Avokat të Mbrojtjes	Për Millan Millutinoviçin: Eugene O' Sullivan dhe Slobodan Zeçeviç Për Nikolla Shainoviçin: Toma Filla dhe Vlladimir Petroviç Për Dragolub Ojdaniçin: Tomislav Vishnjiç dhe Norman Sepenuk Për Nebojsa Pavkoviçin: John Ackerman dhe Aleksandar Aleksiç Për Vlladimir Llazareviçin: Mihajlo Bakraç and Gjuro Çepiç Për Sreten Llukiqin: Branko Llukiq and Dragan Ivetiç

ÇËSHTJE GJYQËSOR QË KANË LIDHJE <i>prej zonës gjeografike</i>	
GJORGJEVIQ (IT-05-87/1.1) "KOSOVA"	
HARADINAJ dhe të tjerë (IT-04-84)	
LIMAJ dhe të tjerë (IT-03-66)	
MILLOSHEVIQ (IT-02-54) "KOSOVA, KROACIA DHE BOSNA"	

AKTAKUZA DHE AKUZAT

Të tëra akuzat kundër Millan Millutinoviçit, Nikolla Shainoviçit, Dragolub Ojdaniçit, Nebojsa Pavkoviçit, Vladimir Llazareviçit and Sreten Llukiqit ishin në lidhje me krime të kryera në territorin e Kosovës duke filluar prej 1 janarit 1999 ose rreth kësaj date deri më 20 qershor 1999.

Aktakuza fillestare kundër Slobodan Millosheviçit, Millan Millutinoviçit, Nikolla Shainoviçit, Dragolub Ojdaniçit dhe Vllajko Stojkoviçit (numri i lëndës IT-99-37) u konfirmua më 24 maj 1999 dhe u bë publike më 27 maj 1999. Kjo aktakuzë u ndryshua më 29 qershor 2001. Aktakuza u ndryshua sërish më 29 tetor 2001 (aktakuza e ndryshuar për herë të dytë) dhe më 5 shtator 2002 (aktakuza e ndryshuar për herë të tretë). Në aktakuzën e ndryshuar për herë të tretë u hoqën akuzat kundër Slobodan Millosheviçit dhe Vllajko Stojkoviçit për shkak të vdekjes së Vllajko Stojkoviçit dhe faktit se Slobodan Millosheviçi po gjykohej veças (numri i lëndës IT-02-54). Më tej çështja gjyqësore u emërtua *Milutinoviç dhe të tjerë*.

Aktakuza fillestare kundër Nebojsa Pavkoviçit, Vladimir Llazareviçit, Vllastimir Gjorgjeviçit dhe Sreten Lukiqit (numri i lëndës IT-03-70), "*Pavkoviç dhe të tjerë*") u konfirmua më 2 tetor 2003 dhe u bë publike më 20 tetor 2003.

Më 1 prill 2005 Prokuroria parshtrroi kërkesën për të bashkuar çështjet *Millutinoviç dhe të tjerë* dhe *Pavkoviç dhe të tjerë*. Kërkesa u miratua më 8 korrik 2005 dhe Dhoma Gjyqësore urdhëroi Prokurorinë që të dorëzonte një aktakuzë të ndryshuar të përbashkët. Aktakuza e ndryshuar e përbashkët u dorëzua më 16 gusht 2005. Kjo aktakuzë u kundërshtua nga Mbrojtja dhe duke u bazuar në një urdhëresë të Dhomës Gjyqësore, Prokuroria paraqiti aktakuzën e ndryshuar për herë të dytë të përbashkët më 5 prill 2006. Më 11 maj 2006, Dhoma Gjyqësore urdhëroi Prokurorinë të dorëzonte kopjen përfundimtare të aktakuzës. Më 12 maj 2006, Prokuroria dorëzoi aktakuzën e ndryshuar për herë të tretë të përbashkët.

Më 17 maj 2006, Gjykatësi Paragjyqësor urdhëroi Prokurorinë të korigjonte disa gabime shtypi në aktakuzën e ndryshuar për herë të tretë të përbashkët dhe ta veçonte Vllastimir Gjorgjeviçin i cili ishte ende në arrati, prej të akuzuarve të tjerë me qëllim që gjykimi kundër të akuzuarve të tjerë të fillonte në datën e caktuar. Më 21 qershor 2006 Prokuroria kërkoi leje për zëvendësimin e aktakuzës së përbashkët të ndryshuar për herë të tretë me variantin e korigjuar të aktakuzës dorëzuar në të njëjtën ditë dhe leje për veçuar Vllastimir Gjorgjeviçit nga kjo çështje gjyqësore. Më 26 qershor 2006 Dhoma Gjyqësore e miratoi veçimin dhe pranoi aktakuzën e përbashkët të ndryshuar për herë të tretë të redaktuar si aktakuza në fuqi kundër gjashtë të akuzuarve. Për Vllastimir Gjorgjeviçin u caktua lënda numër IT-05-87/1.

Në aktakuzë pretendohet se të akuzuarit morën pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale që ekzistonte që prej tetorit 1998 dhe vazhdoi gjatë periudhës kur u kryen krimet e pretenduara në aktakuzë. Qëllimi i ndërmarrjes së përbashkët kriminale ndër të tjera ishte ndryshimi i përbërjes etnike në Kosovë për të mundësuar vazhdimësinë e kontrollit serb mbi krahinën. Ky qëllim do të arrihej nëpërmjet mënyrave kriminale ndër të cilat fushata e gjerë ose sistematike e terrorit dhe dhunës ku përfshiheshin dëbime, vrasje, transferime të dhunshme dhe përndjekje kundër popullatës shqiptare kosovare gjatë periudhës përkatëse të aktakuzës.

Pretendohej se forcat e Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ) dhe Serbisë në mënyrë të qëllimshme dhe të gjerë ose sistematike dëbuan me dhunë dhe shpërngulën brenda vendit qindra mijëra shqiptarë kosovarë prej shtëpive të tyre anembanë krahinës së Kosovës. Për të mundësuar dëbimet dhe shpërnguljet, forcat e RFJ-së dhe Serbisë krijuan qëllimisht një gjendje frike dhe shtypjeje nëpërmjet përdorimit të forcës, kërcënimeve për përdorim të forcës dhe akteve të dhunës.

Në aktakuzë pohohet se në tërë Kosovën, forcat e RFJ-së dhe Serbisë u përfshinë në një fushatë të gjerë ose sistematike të shkatërrimit të pronave të civilëve shqiptarë kosovarë.

Kjo u arrit nëpërmjet granatimit të përhapur të qyteteve dhe fshatrave; djegies dhe shkatërrimit të pronave përfshirë shtëpi, ferma, njësi tregëtuese monumente kulturore dhe objekte fetare dhe shkatërrimit të pronave personale. Si rezultat i këtyre veprimeve të bashkërenduara, qytete, fshatra dhe rajone të tëra u bënë të pabanueshme për shqiptarët kosovarë.

Gjithashtu pretendohet se veç shkatërrimit të qëllimshëm të pronave të civilëve shqiptarë kosovarë, forcat e RFJ-së dhe Serbisë kryen gjerësisht ose sistematikisht veprime brutale dhe të dhunshme kundër civilëve shqiptarë kosovarë për mbajtjen e gjendjes së frikës, krijimin e kaosit dhe të një frike mbytëse për jetën. Forcat e RFJ-së dhe Serbisë shquan fshat më fshat, qytet më qytet, dhe rajon më rajon, duke kërcënuar dhe dëbuar popullatën shqiptare kosovare. Shqiptarët kosovarë vazhdimisht u kërcënuan, sulmuan ose u vranë publikisht për të detyruar largimin e familjeve dhe fqinjëve të tyre. Shumë shqiptarë kosovarë të cilët nuk u dëbuan drejtpërsëdrejti me dhunë prej vendbanimeve të tyre, ikën si pasojë e gjendjes së terrorit krijuar prej rrahjeve, keqtrajtimit, përdhunimeve, arrestimeve të paligjshme, vrasjeve granatimeve dhe plaçkitjeve të kryera gjerësisht ose sistematikisht anembanë krahinës. Forcat e RFJ-së dhe Serbisë vazhdimisht fyen, shanë nga ana racore, i poshtëruan dhe përdorën forma të tjera të keqtrajtimit fizik dhe psikologjik kundër shqiptarëve kosovarë bazuar në identifikimin e tyre racor, fetar dhe politik. U shpërngulën të gjitha kategoritë e shoqërisë shqiptare kosovare duke përfshirë edhe gratë, fëmijët, të moshuarit dhe të sëmurët.

Në aktakuzë pohohet se mijëra shqiptarë kosovarë të cilët ikën prej shtëpive të tyre si pasojë e veprimeve të forcave të RFJ-së dhe Serbisë iu bashkuan kolonave të njerëzve që lëviznin drejt kufijve të Kosovës me Shqipërinë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë (IRJM). Pretendohet se forcat e RFJ-së dhe Serbisë caktuan njerëz në postblloqet përgjatë rrugëtimit për në kalimet kufitare dhe rrahën, u morën pará me forcë, grabitën, keqtrajtuan, sulmuan, arrestuan në mënyrë të paligjshme dhe vranë shqiptarët kosovarë të shpërngulur. Në raste të tjera forcat e RFJ-së dhe Serbisë shoqëruan grupe të shqiptarëve kosovarë të dëbuar për në kufi.

Sipas aktakuzës u dëbuan afërsisht 800,000 shqiptarë kosovarë. Për të mundësuar dëbimet dhe shpërnguljet, forcat e RFJ-së dhe Serbisë krijuan qëllimisht një gjendje frike dhe shtypjeje nëpërmjet përdorimit të forcës, kërcënimeve për përdorim të forcës dhe akteve të dhunës. Anembanë Kosovës, në një përpjekje të qëllimshme dhe të gjerë ose sistematike për të penguar kthimin e shqiptarëve kosovarë të dëbuar në shtëpitë e tyre, forcat e RFJ-së dhe Serbisë grabitën dhe plaçkitën pronat personale dhe bizneset e shqiptarëve kosovarë. Forcat e RFJ-së dhe Serbisë ushtruan bastisje në shkallë të gjerë, kryen kërcënime për dhunë dhe akte dhune për grabitjen e të hollave dhe sendeve të çmuara të shqiptarëve kosovarë dhe autoritetet në postat kufitare të RFJ-së gjerësisht ose sistematikisht vodhën automjete personale dhe pasuri të tjera prej shqiptarëve kosovarë që po dëboheshin prej krahinës.

Gjithashtu anembanë Kosovës, forcat e RFJ-së dhe Serbisë sistematikisht konfiskuan dhe shkatërruan dokumentet identifikuese dhe lejet e automjeteve të civilëve shqiptarë kosovarë. Ndërkohë që shqiptarët kosovarë u dëbuan prej shtëpive të tyre dhe u nisën drejt kufijve të Kosovës, atyre iu kërkua të dorëzonin dokumentet identifikuese në pika të caktuara gjatë rrugëtimit për në kalimet kufitare dhe në kalimet kufitare për në Shqipëri dhe IRJM. Këto veprime u kryen për zhdukjen e krejt dokumenteve të ekzistencës së të dëbuarve shqiptarëve kosovarë në Kosovë dhe për t'iu mohuar atyre të drejtën e kthimit në shtëpitë e tyre.

Shkurtimisht pretendohet se anembanë Kosovës forcat e RFJ-së dhe Serbisë sistematikisht granatuan qytete dhe fshatra, dogjën shtëpi dhe ferma, dëmtuan dhe shkatërruan insitucione kulturore dhe fetare të shqiptarëve kosovarë, vranë civilë shqiptarë kosovarë dhe persona të tjerë që nuk merrnin pjesë aktivisht në luftime dhe sulmuan seksualisht gra shqiptare kosovare.

Në Aktakuzën në fuqi, bazuar në përgjegjësinë e tyre individuale penale (Neni 7(1) i Statutit) dhe në përgjegjësinë e tyre penale si epror (Neni 7(3) i Statutit), Millan

Millutinoviqi, Nikolla Shainoviqi, Dragolub Ojdaniqi, Nebojsa Pavkoviqi, Vlladimir Llazareviqi dhe Sreten Llukiqi u akuzuan për:

- Dëbim, veprime të tjera çnjerëzore (transferim i dhunshëm), vrasje, përndjekje mbi baza politike, racore ose fetare (krime kundër njerëzimit, Neni 5),
- Vrasje (shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, Neni 3).

FAZA PARAGJYQËSORE

Pas vendimit të Dhomës Gjyqësore të 14 prillit 2005, të akuzuarit Millan Millutinoviqi, Dragolub Ojdaniqi, Nikolla Shainoviqi dhe Vlladimir Llazareviqi u liruan përkohësisht me kusht më 15 prill 2005.

Bazuar në vendimin e Dhomës Gjyqësore të 3 tetorit 2005, Sreten Llukiqi u lirua përkohësisht me kusht më 5 tetor 2005.

Bazuar në vendimin e Dhomës Gjyqësore më 18 nëntor 2005, Nebojsa Pavkoviqi u lirua përkohësisht me kusht më 21 nëntor 2005.

Të gjithë të akuzuarit u kthyen në Njësinë e Paraburgimit më 4 korrik 2006.

PROCESI GJYQËSOR

Procesi gjyqësor *Millutinoviqi dhe të tjerë* filloi më 10 korrik 2006. Të akuzuarve iu miratua lirim i përkohshëm me kusht për periudhën 15-31 korrik 2006. Prokuroria e përfundoi argumentimin e saj për çështjen më 1 maj 2007.

Paraqitja e argumentimit të çështjes prej Mbrojtjes filloi më 6 gusht 2007 dhe përfundoi 16 maj 2008

Prej 19 majit deri më 21 maj 2008, palët i bënë pyetje një dëshmitari të thirrur prej Dhomës Gjyqësore. Më 8 dhe 9 korrik 2008 palët i bënë pyetje një dëshmitari tjetër të thirrur nga Dhoma Gjyqësore

Argumentet përmbyllëse u dëgjuan prej 19 gushtit deri më 27 gusht 2008

PROCEDURA E RREGULLËS 98bis

Pas përfundimit të paraqitjes së provave prej Prokurorisë, Dhoma Gjyqësore mund të vendosë nëse nevojitet përgjigje ndaj këtyre provave. Nëqoftëse Dhoma beson se Prokuroria nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme për të vërtetuar një/disa akuzë(a), ajo mund t'i hedhë poshtë këto akuza dhe të japë verdikt pafajësie para fillimit të paraqitjes së provave prej Mbrojtjes.

Më 18 maj 2007, Dhoma Gjyqësore në çështjen *Millutinoviqi dhe të tjerë* shpalli me anë të një vendimi gojor bazuar në Rregullën 98 bis se ekzistonin prova të mjaftueshme në mbështetje të verdiktit të fajësisë për krimet e akuzuara në lidhje me të tëra akuzat. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësori hodhi poshtë mocionet e Mbrojtjes për dhënien e pafajësisë në lidhje me çdo të akuzuar.

AKTGJYKIMI I DHOMËS GJYQËSORE

Aktgjykimi u shpall më 26 shkurt 2009.

Përgjithësisht Dhoma Gjyqësore konkludoi se u krye një fushatë e gjerë e dhunës kundër popullatës civile të shqiptarëve kosovarë gjatë sulmeve ajrore të NATO-s, kryer prej forcave nën kontrollin e RFJ-së dhe Serbisë, ku pati vrasje, sulme seksuale dhe shkattërim të qëllimshëm të xhamive. Ishin veprimet e qëllimshme të këtyre forcave gjatë kësaj fushate që shkaktuan largimin e së paku 700,000 shqiptarëve kosovarë nga Kosova brenda një kohe të shkurtër prej fundit të marsit deri në fillim të qershorit 1999. Përpjekjet e MPB-së për fshehjen e vrasjeve të shqiptarëve kosovarë nëpërmjet transportimit të kufomave në zona të tjera të Serbisë tregojnë se këto ishin vrasje kriminale.

Millan Millutinoviç ishte President i Serbisë gjatë viteve 1998 dhe 1999 dhe pjesa më e madhe e provave të paraqitura nga Prokuroria dhe Mbrojtja e tij kishin lidhje me brendinë dhe gjerësinë e kompetencave të tija në atë detyrë. Dhoma konkludoi se si President i Serbisë, Millutinoviç nuk kishte kontroll individual të drejtpërdrejtë mbi UJ-në si institucion federal. Formalisht roli i tij në lidhje me UJ-në ishte si anëtar ex officio i Këshillit të Lartë të Mbrojtjes ose KLM i përbërë prej Presidentit të RFJ-së Slobodan Millosheviç si dhe Presidentët e Serbisë dhe Malit të Zi dhe që merrte vendime strategjike në lidhje me UJ-në. Mirëpo prej këqyrjes së procesverbaleve të mbledhjeve të KLD-së të pranura si prova nuk u gjet formulim ose zbatim i planit të përbashkët pretenduar në aktakuzë. Për më tepër nuk pati prova të drejtpërdrejta të mbledhjeve të KLD-së pas 23 marsit 1999, vigjilja e fushatës ajrore të NATO-s, megjithëse Dhoma u bind se Millutinoviç dhe Presidenti i RFJ-së Millosheviç vazhduan takimet gjatë bombardimit të NATO-s dhe formalisht mbanin komandën e UJ-së nëpërmjet KLM-së ose një organi të ngjashëm i njohur si Komanda e Lartë. Mirëpo provat nuk treguan se Millutinoviç ishte pjesëmarrës në ushtrimin e komandës mbi UJ-në pas 23 marsit 1999. Gjithashtu Dhoma konkludoi se praktikisht ishte Millosheviç, në disa raste i cilësuar “Kryekomandanti”, ai që ushtroi komandë aktuale mbi UJ-në gjatë fushatës së NATO-s . Në vitin 1998 dhe në fillim të vitit 1999 Millutinoviç mori pjesë në negociatat me përfaqësuesit e shqiptarëve kosovarë dhe në negociatat e ndërmytesuara prej bashkësisë ndërkombëtare në përpjekje për zgjidhjen e krizës së Kosovës. Pas analizimit të provave të shumta në lidhje me negociatat, Dhoma nuk u bind se provat tregojnë se Millutinoviç kishte patur qasje penguese për të shkaktuar dështimin e negociatave siç argumentoi Prokuroria. Gjithashtu provat e paraqitura nga Prokuroria nuk e bindën Dhomën se Millutinoviç kishte lidhje të afërt personale ose profesionale me Millosheviçin, ose se kishte pozitë ndikuese qenësore në Partinë Socialiste të Serbisë, partia politike kryesore në atë kohë. Dhoma konkludoi se ai ishte relativisht i mirinformuar për situatën në Kosovë dhe se ishte në dijeni të kryerjes së veprimeve kriminale prej forcave të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë në vitin 1998 dhe në fillim të vitit 1999, kryesisht nëpërmjet kontakteve të tija me diplomatë, negociatorë dhe vëzhgues të huaj. Mirëpo nga ana tjetër zyrtarë shtetërorë i thanë se çfarëdo krimesh të kryera në Kosovë kishin gjetur zgjidhje. Dhoma Gjyqësore konkludoi se si President i Serbisë Millutinoviç kishte kompetenca që me gjasë mundësonin mbikëqyrje të konsiderueshme të funksionimit të ministrive të qeverisë serbe, dhe çka është më e rëndësishme edhe Ministrinë e Brendshme. Mirëpo provat nuk vërtetojnë kontakte të shumta midis Millutinoviçit dhe MPB-së në periudhën përkatëse dhe pushteti i tij *de facto* mbi Ministrinë e Brendshme nuk ishte qenësor. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore nuk u bind jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Millan Millutinoviç dha kontribut të ndjeshëm në ndërmarrjen e përbashkët kriminale. Për më tepër Dhoma nuk u bind se Millutinoviç kishte synim të përbashkët për përdorimin e metodave kriminale, gjegjësisht dëbime dhe transferime të dhunshme për ruajtjen e kontrollit shtetëror mbi Kosovën

Veç pozitës si Zëvendëskryeministër i RFJ-së, Nikolla Shainoviç ishte Kryetar i Komisionit të RFJ-së për Bashkëpunim me Misionin e Verifikimit në Kosovë të OSBE-së, krijuar pas marrëveshjeve të ndryshme të realizuara në tetor 1998 prej autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë dhe bashkësisë ndërkombëtare. Dhoma konkludoi se organi i njohur prej disave si Komandë e Përbashkët në fakt u shfaq në mes të vitit 1998, me synim bashkërendimin e veprimtarisë së UJ-së, MPB-së dhe organeve të tjera shtetërore të përfshirë në konfliktin e

Kosovës. Shënime të mbledhjeve të Komandës së Përbashkët prej korrikut në tetor të vitit 1998, të pranuar si prova, të mbajtura prej një pjesëmarrësi, ofruan njohuri në lidhje me këtë organ. Këto shënime zbulojnë se Shainoviqi ishte pjesëmarrës aktiv në mbledhjet e Komandës së Përbashkët, po ashtu si edhe të Akuzuarit Pavkoviç dhe Lluqiç dhe në disa raste, Llazareviçi. Në fakt Shainoviqi lëshoi udhëzime në mbledhje, ndër të cilat edhe për çështje në lidhje me veprimtarinë e UJ-së dhe MPB-së. Ekzistojnë prova të drejtpërdrejta vetëm të një mbledhjeje në qershor të vitit 1999, mirëpo urdhëresat ushtarake u lëshuan me emblemën e Komandës së Përbashkët, për të mundësuar bashkëpunimin dhe bashkërendimin e forcave të MPB-së dhe UJ-së. Gjithashtu Shainoviqi mori pjesë në një sërë takimesh të tjera të nivelit të lartë për gjendjen në Kosovë në 1998 dhe 1999 dhe ishte shpesh i pranishëm në Kosovë si në 1998 po ashtu edhe gjatë fushatës ajrore të NATO-s. Presidenti i RFJ-së Millosheviç ishte përcaktues në dërgimin e tij në Kosovë prej verës së vitit 1998 dhe në emërimin e tij si Kryetar i Komisionit për Bashkëpunim me Misionin e Verifikimit në Kosovë në tetor 1998, fakt që i mundësoi atij mbajtjen e kontakteve me personelin e UJ-së dhe MPB-së në Kosovë si dhe me vëzhguesit ndërkombëtarë të atjeshëm. Rrjedhimisht vazhduan pa ndërprerje kontaktet e tij me të Akuzuarin Pavkoviç të UJ-së dhe Lluqiçin e MPB-së dhe ndikimi i tij ndaj tyre. Shainoviqi u takua shpesh me Millosheviçin gjatë vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999 si dhe bisedoi shpesh në telefon me të dhe një sërë dëshmitarësh dëshmuar për natyrën e marrëdhënieve të tyre. Mbi bazën e këtyre provave, Dhoma konkludon se Shainoviqi ishte një nga ndihmësit më të afërt dhe më të besuar të Millosheviçit, faktor që e ndihmoi atë në marrjen e një roli kryesor në Komandën e Përbashkët dhe në Komisionin për Bashkëpunim me MVK-në. Ai ishte zyrtar me pozitë të fuqishme në qeverinë e RFJ-së, i cili jo vetëm i përcillte informacion Millosheviçit dhe përcillte udhëzimet e Millosheviçit për zyrtarët e Kosovës, por kishte edhe ndikim të madh mbi ngjarjet në krahinë dhe kishte kompetencë për marrjen e vendimeve.

Shainoviqi u takua me udhëheqësin e atëhershëm politik shqiptar kosovar Ibrahim Rugova gjatë fushatës ajrore të NATO-s, gjatë periudhës kur Rugova efektivisht ishte në arrest shtëpie. Dhoma nuk i konsideroi këto takime si përpjekje e njëmendtë për gjetjen e një zgjidhjeje për Kosovën, por si fushatë ku u përfshinë edhe kërcënime ndaj sigurisë individuale të Rugovës, e projektuar për të treguar se autoritetet e RFJ-së dhe të Serbisë po bisedonin me shqiptarët e Kosovës me shpresë se kështu do të ndërpriteshin bombardimet e NATO-s. Shainoviqi mori pjesë me vetëdije dhe qëllimisht në këtë fushatë. Gjithashtu Dhoma konstatoi se Shainoviqi ishte i mirinformuar për ngjarjet në Kosovë si për vitin 1998 po ashtu edhe për 1999 dhe se ishte në dijeni për kryerjen e veprimeve kriminale të forcave të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999, përfshirë edhe periudhën gjatë bombardimeve të NATO-s. Shainoviqi nuk ushtroi pushtetin e tij të gjerë në Kosovë dhe iniciativën e tij për të mundësuar ndërprerjen e veprimeve kriminale. Dhoma u bind se Nikolla Shainoviqi kishte pushtet të konsiderueshëm *de facto* mbi MPB-në dhe UJ-në që vepronin në Kosovë, dhe se ai ishte bashkërenduesi politik i këtyre forcave. Ajo u bind se ai dha kontribut të ndjeshëm në ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe se në fakt ishte një prej anëtarëve më të rëndësishëm të ndërmarrjes së përbashkët. Bazuar në të tëra provat, Dhoma konkludon se i vetmi përfundim i arsyeshëm është se Shainoviqi kishte synim shpërnguljen me dhunë të popullatës shqiptare kosovare si brenda Kosovës po ashtu dhe jashtë saj dhe nëpërmjet kësaj ndryshimin e përbërjes etnike në krahinë dhe garantimin e vazhdimësisë së kontrollit shtetëror mbi të. Gjithashtu Dhoma konkludoi se vrasja e civilëve shqiptarë kosovarë prej forcave të UJ-së dhe MPB-së në zbatim të planit të përbashkët kriminal si edhe shkatërrimi apo dëmtimi i objekteve fetare, konkretisht xhamive, ishin logjikisht të parashikueshme për Shainoviçin. Mirëpo shumica e Dhomës nuk gjykon se kryerja e sulmeve seksuale ishte e parashikueshme për të.

Gjykatësi Chohan shprehu mospajtim në lidhje me parashikueshmërinë e sulmeve seksuale për Shainoviçin.

Si Shef i Shtabit të Përgjithshëm, Dragolub Ojdaniqi mori pjesë në mbledhjet e KLM-së dhe ishte pjesëmarrës aktiv në diskutime. Provat nuk vërtetuan se ai mori pjesë në organin e quajtur Komanda e Përbashkët por ishte në dijeni dhe e pranoi funksionimin e saj. Gjithashtu ai ishte në dijeni të përfshirjes së UJ-së në armatosjen e popullatës civile joshqiptare në Kosovë. Po ashtu ai përkrahu emërimin e personelit të UJ-së në pozita të larta, të cilët ose mbështetën veprimtarinë e UJ-së në Kosovë si i akuzuari Pavkoviç, ose thjesht nuk shprehën asnjë kundërshtim në lidhje me të, dhe ishte në dijeni të largimit nga detyra të oficerëve të lartë të UJ-së të cilët kundërshtuan përdorimin e UJ-së në Kosovë. Deri në fillimin e fushatës ajrore të NATO-s dhe gjatë saj, Ojdaniqi lëshoi urdhëresa drejtuar UJ-së për kryerjen e operacioneve anembanë Kosovës, ndër të cilat edhe ndihmesa ndaj MPB-së. Gjithashtu ai mobilizoi njësi shtesë të UJ-së për dislokim në Kosovë gjatë periudhës kur ndodhi shumica e krimeve të vërtetuara prej Dhomës.

Nëpërmjet sistemit raportues të UJ-së, Ojdaniqi u mbajt i mirinformuar përditë në lidhje me gjendjen në terren në Kosovë, para dhe gjatë bombardimeve të NATO-s. Në vitet 1998 dhe 1999 atij iu përcoll informacion konkret për përdorimin e tepruar ose pa dallim të forcës prej njërive të UJ-së dhe MPB-së. Ai ishte gjithashtu në dijeni se vullnetarët e përfshirë në radhët e UJ-së gjatë bombardimeve të NATO-s kishin marrë pjesë në kryerjen e veprimeve kriminale. Në fakt ai ndërmori disa hapa si reagim ndaj raporteve që merrte, si p.sh lëshimi i urdhëresave për respektimin e normave të së drejtës humanitare ndërkombëtare, aktivizimi i sistemit të drejtësisë ushtarake, dhe dërgimi i oficerëve të lartë prej Administratës së Sigurimit për hetime. Gjithsesi ai vazhdoi të urdhëronte pjesëmarrjen e UJ-së në operacione ushtarake në Kosovë së bashku me MPB-në. Dhoma konkludoi se megjithëse disponohen prova të konsiderueshme në mbështetje të akuzës së Prokurorisë se Dragolub Ojdaniqi ishte mbështetës i kryerjes së krimeve anembanë Kosovës prej forcave të UJ-së dhe MPB-së në një sulm të gjerë dhe sistematik kundër shqiptarëve kosovarë, nuk u vërtetua jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ai kishte synim garantimin e vazhdimësisë së kontrollit shtetëror mbi krahinën nëpërmjet dëbimeve dhe transferimit të dhunshëm të një pjese të konsiderueshme të popullatës shqiptare kosovare. Mirëpo Dhoma konkludoi se me veprimet e tija në vazhdimësi në komandë të forcave të UJ-së në varësi të tij, Ojdaniqi dha ndihmesë praktike, inkurajim ose përkrahje morale ndaj anëtarëve të UJ-së për të cilët ai dinte se synonin të kryenin dëbim dhe transferim të dhunshëm. Sjellja e tij ushtroi ndikim të konsiderueshëm në kryerjen aktuale të këtyre krimeve prej forcave të UJ-së në disa vendndodhje të përmendura në Aktakuzë. Mirëpo Dhoma konkludoi se Ojdaniqi nuk kishte dijeni se forcat e UJ-së synonin të vrisnin ose të sulmonin seksualisht civilët shqiptarë kosovarë, ose të dëmtonin apo shkatërronin objekte fetare.

Në vitin 1998 Nebojsa Pavkoviç ishte Komandant i Korpusit të Prishtinës të UJ-së, që kishte përgjegjësi për territorin e Kosovës. Në fund të atij viti ai u bë Komandant i Armatës së Tretë që përfshinte Korpusin e Prishtinës dhe Korpusin e Nishit. Në të dy funksionet ai kishte kontroll *de jure* dhe *de facto* mbi njësitë në varësi të tij, dhe luajti rol qendror në planifikimin dhe zbatimin e veprimtarisë së UJ-së në Kosovë në bashkërendim me MPB-në. Në fakt Dhoma dëgjoi dëshmi bindëse se në vitin 1998 ai mbështeti idenë për një rol më të madh të UJ-së në Kosovë dhe u vu në krye të propozimeve për veprime konkrete të UJ-së dhe MPB-së. Ai kishte kontakt të drejtpërdrejtë me Presidentin e RFJ-së, Millosheviç, i cili i përkrahu dhe miratoi propozimet e tij, me gjithë protestat prej të tjerëve në UJ. Gjatë kohës si Komandant i Korpusit të Prishtinës, Pavkoviç u konfliktua me eprorin e tij të drejtpërdrejtë, Komandantin e atëhershëm të Armatës së Tretë dhe pa dyshim kishte mosmarrëveshje me Shefin e atëhershëm të Shtabit të Përgjithshëm në lidhje me përdorimin e UJ-së në Kosovë, të cilët u hoqën që të dy nga detyra dhe Pavkoviç u bë Komandant i Armatës së Tretë. Dhoma konstatoi se në vitin 1998, Pavkoviç u përfshi në armatosjen e popullatës civile joshqiptare në Kosovë dhe njëkohësisht çarmatosjen e shqiptarëve kosovarë, megjithëse ishte në dijeni të ndasisë dhe armiçësisë etnike në Kosovë.

Si Komandant i Korpusit të Prishtinës në 1998, Pavkoviç lëshoi urdhëresa të shumta për dislokimin e njërive të UJ-së shpesh në operacione të përbashkëta me MPB-në. Ai u informua mbi pretendimet për përdorimin e tepruar dhe pa dallim të forcës prej UJ-së dhe MPB-së në Kosovë, ndër të tjera nëpërmjet pjesëmarrjes së tij të shpeshtë në mbledhjet e

Komandës së Përbashkët ku u diskutua hollësisht gjendja në Kosovë, dhe megjithatë vazhdoi t'i hidhte në veprim njësitë e tij. Sapo u bë Komandant i Armatës së Tretë, ai pruri njësi shtesë në Kosovë për zgjerimin e UJ-së dhe dërgoi një brigadë të posaçme në brendësi të Kosovës në kundërshtim të një udhëzimi të drejtpërdrejtë të Ojdaniqit. Deri në fillimin e fushatës ajrore të NATO-s dhe gjatë saj, si Komandanti i Armatës së Tretë, Pavkoviqi vazhdoi të lëshonte urdhëresa për kryerjen e operacioneve prej njësite të UJ-së në Kosovë, ndër të tjera edhe në zona ku Dhoma vërtetoi kryerjen e krimeve prej forcave të UJ-së dhe MPB-së. Gjithashtu ai vazhdoi të bashkëpunonte ngushtë me Presidentin e RFJ-së Millosheviq në këtë periudhë. Gjithsesi ai nuk kishte kontroll të drejtpërdrejtë mbi forcat e MPB-së të angazhuara në Kosovë, pavarësisht urdhëresave për rivendosjen e vartësisës së MPB-së ndaj UJ-së lëshuar në prill 1999. Në 1998 dhe 1999, Pavkoviqi më të shumtën e kohës ishte i pranishëm në Kosovë. Nëpërmjet pranisë së tij në Komandën e Përbashkët dhe në mbledhje të tjera në 1998, sistemit të rregullt raportues të UJ-së dhe inspektimeve të tija në njësitë e UJ-së dislokuar anembanë Kosovës, ai kishte njohuri të hollësishme dhe një ide të plotë të gjendjes në terren dhe të veprimeve të forcave të tija dhe të MPB-së. Këto njohuri përfshinin edhe kryerjen e krimeve prej forcave të UJ-së dhe MPB-së, ndër të cilat shpërngulja me dhunë e shqiptarëve kosovarë, vrasjet dhe sulmet seksuale ndaj tyre. Në fakt Dhoma konstatoi se megjithëse Pavkoviqi dinte për veprime kriminale të kryera prej pjesëtarve të UJ-së në Kosovë, në disa raste ai raportoi fare pak dhe minimizoi veprat e rënda kriminale në raportet e tij dërguar Shtabit të Komandës së Lartë. Megjithëse ai lëshoi disa urdhëresa për respektimin e normave të së drejtës humanitare ndërkombëtare gjatë kryerjes së këtyre operacioneve, Dhoma nuk gjykoj se këto ishin masa të njëmendëta për kufizimin e kryerjes së krimeve në Kosovë. Dhoma konkludoi se Nebojsa Pavkoviqi kishte pushtet qenësor komandues *de jure* dhe *de facto* mbi forcat e UJ-së në Kosovë në 1998 dhe 1999 dhe kishte një pozitë ndikuese, përfshirë edhe pjesëmarrjen e tij në Komandën e Përbashkët. Nuk ka dyshim se kontributi i tij në ndërmarrjen e përbashkët kriminale ishte i konsiderueshëm, duke qenë se ai përdori forcat e UJ-së në dispozicion të tij për të terrorizuar dhe përzënë me dhunë civilët shqiptarë kosovarë prej shtëpive të tyre. Gjithashtu Dhoma konkludoi se përfundimi i vetëm i logjikshëm prej të tëra provave është se Pavkoviqi kishte synim shpërnguljen me dhunë të popullatës shqiptare kosovare për të garantuar vazhdimësinë e kontrollit shtetëror mbi krahinën. Për më tepër, Dhoma gjykoj se në ato rrethana, kryerja e vrasjeve, sulmeve seksuale dhe shkatërrimi ose dëmtimi i qëllimshëm i xhamive prej forcave të UJ-së dhe MPB-së në zbatim të urdhrave të tij, ishin logjikisht të parashikueshme për Pavkoviqin.

Kur Pavkoviqi u bë Komandant i Armatës së Tretë në fund të vitit 1998, ish-Shefi i Shtabit të tij në Korpusin e Prishtinës, Vlladimir Llazareviqi u emërua në vend të tij si Komandant i Korpusit të Prishtinës. Gjatë ushtrimit të këtyre funksioneve Llazareviqi ishte i bazuar në Kosovë, fillimisht në Gjakovë dhe më vonë në Prishtinë dhe rreth saj. Një prej detyrave të tij si Shef i Shtabit të Korpusit të Prishtinës ishte monitorimi i kufirit shtetëror ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Gjithashtu ai kontribuoi në zbatimin e operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së në atë zonë në gjysmën e dytë të vitit 1998. Dhoma konkludoi se në vitin 1998 Llazareviqi ishte në dijeni të faktit se në Kosovë po kryheshin veprime kriminale kundër civilëve dhe pronave të civilëve gjatë operacioneve të UJ-së dhe MPB-së. Gjithashtu ai dinte se kjo shkaktoi shpërnguljen e një numri të madh civilësh. Pas emërimit të tij si Komandant i Korpusit të Prishtinës, Llazareviqi kishte kontroll *de jure* dhe *de facto* mbi njësitë në varësi të tij, ndër të cilat njësitë e rregullta të UJ-së dhe prej fillimit të prillit 1999, repartet ushtarake territoriale. Ai nuk kishte kontroll të drejtpërdrejtë mbi njësitë e MPB-së të angazhuara në Kosovë. Provat vërtetuan se pjesëmarrja e Llazareviqit në planifikimin dhe zbatimin e operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së të kryera prej marsit në qershor 1999 në Kosovë, ishte e konsiderueshme përfshirë edhe vendet për të cilat Dhoma vërtetoi kryerjen e krimeve. Ai vazhdoi të vepronte në këtë mënyrë, me gjithë dijeninë e tij për kryerjen e krimeve të tilla. Mirëpo në ndryshim nga Pavkoviqi, Llazareviqi nuk u përfshi, ose jo domosdoshmërisht ishte në dijeni të tërë procesit të vendimmarrjes politike në Beograd dhe nuk mori pjesë në mbledhjet e nivelit të lartë atje. Dhoma konkludoi se megjithëse ekzistonin prova të konsiderueshme në mbështetje të akuzës së Prokurorisë se Vlladimir Llazareviqi ishte mbështetës i kryerjes së krimeve anembanë Kosovës prej forcave të UJ-së dhe MPB-së në një sulm të gjerë dhe sistematik

kundër shqiptarëve kosovarë, nuk u vërtetua jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se ai kishte synim garantimin e vazhdimësisë së kontrollit shtetëror mbi krahinën nëpërmjet dëbimeve dhe transferimit të dhunshëm të një pjese të konsiderueshme të popullatës shqiptare kosovare. Mirëpo Dhoma konkludoi se me veprimet e tija në vazhdimësi në komandë të forcave të UJ-së në varësi të tij, Llazareviqi dha ndihmesë praktike, inkurajim ose përkrahje morale ndaj anëtarëve të UJ-së për të cilët ai dinte se synonin të kryenin dëbim dhe transferim të dhunshëm. Sjellja e tij ushtroi ndikim të konsiderueshëm në kryerjen aktuale të këtyre krimeve prej forcave të UJ-së në disa vendndodhje të përmendura në Aktakuzë. Mirëpo Dhoma konkludon se Llazareviqi nuk kishte dijeni se forcat e UJ-së synonin të vrisnin ose sulmonin seksualisht civilët shqiptarë kosovarë, ose të dëmtonin apo shkatërronin objekte fetare.

Thelbi i ballafaqimit gjatë procesit gjyqësor në lidhje me pretendimin për përgjegjësinë penale të Sreten Llukiqit u përqëndrua mbi veçoritë dhe kompetencat e organit të quajtur Shtabi i MPB-së për Kosovën, kreu i të cilit ishte Llukiqi. Mbrojtja e Llukiqit solli një sërë dëshmitarësh të cilët dëshmuuan se Shtabi i MPB-së kishte detyra logjistike dhe aspak kompetenca apo pushtet të vërtetë mbi forcat e MPB-së të dislokuara në Kosovë në 1998 dhe 1999. Këto dëshmi ndryshojnë shumë prej përmbajtjes së vendimeve themeluese të këtij organi ku përcaktohen detyrat e tij, si dhe prej shumë provave të tjera dokumentare ku zbulohet roli i luajtur prej Shtabit të MPB-së në vitin 1998 dhe gjysmën e parë të vitit 1999. Disa dëshmitarë gjithashtu i atribuon një masë më të madhe përgjegjësie Shtabit të MPB-së dhe Llukiqit në krye për forcat e ndryshme të MPB-së në Kosovë, krahasuar me parashtrimet e Mbrojtjes së Llukiqit. Dhoma u bind se Shtabi i MPB-së ishte organ kyç në 1998 dhe 1999, me pushtet të konsiderueshëm mbi njësitë në varësi të Departamentit të Sigurisë Publike të MPB-së, ndër të cilat njësitë e policisë speciale kur u dislokuan në Kosovë, megjithëse nuk zëvendësoi linjën komanduese brenda njërive dhe sekretariateve të ndryshme brenda MPB-së. Shtabi i MPB-së bashkëpunoi me UJ-në për të mundësuar bashkërendim të plotë të veprimtarisë së MPB-së dhe UJ-së në Kosovë, dhe kishte rol të rëndësishëm në planifikimin e operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së. Gjithashtu ai shërbeu si urë lidhëse për selinë e MPB-së në Beograd ku raportonte rregullisht. Dhoma u bind se si kreu i Shtabit të Përgjithshëm të MPB-së, Llukiqi ishte mveshur me pushtet të konsiderueshëm mbi forcat e MPB-së që përgjigjeshin para Shtabit të MPB-së. Në fakt diplomatët dhe vëzhguesit e huaj me të cilat ai pati kontakte dhe takime në Kosovë, në emër të MPB, kuptuan se ai ishte komandant i forcave të MPB-së në Kosovë. Gjithashtu ai mori pjesë rregullisht në mbledhje të nivelit të lartë të Komandës së Përbashkët dhe mbledhje të tjera të nivelit të lartë në Beograd. Rrjedhimisht Dhoma konkludoi se Llukiqi ishte komandant *de facto* i forcave të MPB-së në Kosovë prej mesit të vitit 1998 deri në mes të vitit 1999, si edhe hallkë lidhëse midis operacioneve në terren të forcave të MPB-së në Kosovë dhe politikave e planeve të përgjithshme të vendosura në Beograd. Provat vërtetuan se Llukiqi kishte njohuri të hollësishme të ngjarjeve në Kosovë, gjatë zhvillimit të tyre, si dhe u informua në lidhje me pretendimet për veprime kriminale të personelit të MPB-së atje. Mirëpo Dhoma nuk u bind prej provave të paraqitura se Llukiqi mori pjesë në fshehjen e këtyre krimeve nëpërmjet transportimit klandestin të kufomave të civilëve nga Kosova në pjesë të tjera të Serbisë. Dhoma konkludoi se Sreten Llukiqi kishte pushtet të qenësishëm mbi njësitë e MPB-së të dislokuara në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999 dhe se ishte përgjegjës për planifikimin, organizimin, kontrollimin dhe drejtimin e veprimtarisë së MPB-së në krahinë. Gjithashtu ai bashkëpunoi ngushtë me udhëheqjen e UJ-së dhe instancave të tjera shtetërore dhe mori pjesë në mbledhje të nivelit të lartë për diskutimin e gjendjes në Kosovë. Bazuar në të tëra provat, Dhoma konkludoi se Llukiqi ishte në fakt pjesëmarrës i rëndësishëm në ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe dha kontribut të ndjeshëm nëpërmjet kontrollit prej tij të forcave të MPB-së të përfshira në zbatimin e planit. Gjithashtu Dhoma konkludoi se i vetmi përfundim logjik është se Llukiqi kishte synim shpërnguljen me dhunë të popullatës shqiptare kosovare për garantimin e vazhdimësisë së kontrollit shtetëror mbi krahinën. Gjithashtu u konkludua se vrasjet e civilëve shqiptarë kosovarë prej forcave të UJ-së dhe MPB-së që zbatonin planin e përbashkët si dhe shkatërrimi ose dëmtimi i objekteve fetare, si xhamitë, ishin logjikisht të parashikueshme për Llukiqin. Mirëpo shumica e Dhomës nuk konkludoi se kryerja e sulmeve seksuale ishte e parashikueshme për të.

Gjykatësi Chowhan shprehu mospajtim në lidhje me parashikueshmërinë e sulmeve seksuale për Llukiqin.

Më 26 shkurt 2009, Dhoma Gjyqësore shpalli vendimin:

Millan Millutinoviçi u shpall i pafajshëm në lidhje me të tëra akuzat dhe u lirua

Në bazë të përgjegjësisë individuale penale (Neni 7(1) i Statutit të Tribunalit), Nikolla Shainoviçi, Nebojsa Pavkoviçi dhe Sreten Llukiqi u shpallën fajtorë për:

- Dëbim, veprime të tjera çnjerëzore (transferim i dhunshëm), vrasje, përndjekje mbi baza politike, racore dhe fetare (krime kundër njerëzimit, Neni 5)
- Vrasje (shkelje e ligjeve dhe zakoneve të luftës, Neni 3)

Dënimi: 22 vjet burgim

Në bazë të përgjegjësisë individuale penale (Neni 7(1) i Statutit të Tribunalit), Dragolub Ojdaniçi dhe Vladimir Llazareviçi u shpallën fajtorë për:

- Dëbim dhe veprime të tjera çnjerëzore (transferim i dhunshëm) (krime kundër njerëzimit, Neni 5):

Dënimi: 15 vjet burgim

PROCEDURA E APELIT

Më 27 maj 2009, Prokuroria dorëzoi njoftimin për apel në lidhje me të tërë të akuzuarit përveç Millan Millutinoviçit. Ekipet e Mbrojtjes i dorëzuan njoftimet e tyre për apel në të njëjtën ditë.

Më 21 gusht 2009, Prokuroria dorëzoi përmbledhjen e saj të apelit.

Më 23 shtator 2009, të gjitha ekipet e Mbrojtjes dorëzuan përmbledhjet e tyre të apelit.

Me 30 shtator 2009, mbrojtja e Pavkoviçit dorëzoi përmbledhjen e saj të plotësuar të apelit.

Me 7 dhe 20 tetor 2009 respektivisht, mbrojtja e Llukiqit dhe Llazareviçit kane ridorëzuar përmbledhjet e tyre të apelit. Me 11 dhjetor 2009, mbrojtja e Ojdaniçit dorëzoi përmbledhjen e saj të plotësuar të apelit.